



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš
Drejtoria e Arsimit
Direktorijati za Obrazovanje



Nr. prot. 13/1486 Me 29.12.2024
Br. prot. dt.
DRAGASH - DRAGAŠ



Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality

DREJTORIA PËR ARSIM

02 Nr. Br. 020/01 - 5962/24
11.03/2024

Dragash - Dragaš

DATË /A	29.12.2023
REFERENCË	13/1486
PËR:	z. Bexhet Xheladini, Kryetar i Komunës në Dragash
CC:	z. Resul Fetahu, Nënkyetar i Komunës në Dragash z. Fejsal Halilovic, Nënkyetar i Komunës në Dragash
NGA:	z. Zeni Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Dragash
LËNDA:	Raport i punës për vitin 2023

Drejtoria për Arsim në vitin 2023 ka realizuar aktivitetet e veta në kuadër të dinamikës dhe vëllimit të punës të përfshira në planin e veprimit për këtë vit. Realizimi i detyrave të punës është bërë në harmoni të plotë me Statutin e Kuvendit Komunal, Ligjin për arsimin parauniversitar të Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 dhe Udhëzimeve Administrative të nxjerra nga MASHT-i.

Në komunën tonë funksionale janë 36 objekte shkollore dhe atë:

Shkolla AMË	Shkolla Satelite	SHML – Mesme e lartë
12	23	1

Të gjitha këto shkolla janë në kuadër të arsimit publik ngase në territorin e komunës së Dragashit nuk funksionon asnjë shkollë private.

Vlen të theksohet se kanë përfunduar punimet e Çerdhes në Dragash dhe pritet të funksionalizohet

Procesi arsimor është i organizuar në këto nivele:

- Arsim parafillor- organizohet me qëllim të përgatitjes së fëmijëve për vazhdimin e shkollës fillore dhe funksionon në kuadër të objekteve të shkollave fillore.

- Arsim fillor – në kuadër të këtij niveli përfshihen klasat 1-5 gjegjësisht moshat 6 deri në 10 vjeç,

- Arsimi i mesëm i ulët - përfshin klasat 6-9 gjegjësisht moshat 11 deri në 14. Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është i obliguar dhe zgjat 9 vite.

- Arsimi i mesëm i lartë- është i organizuar në:
- Arsimin e përgjithshëm (gjimnaz),
- Arsimin profesional.

Kohëzgjatja e këtij niveli është 3 vjet varësisht nga profilet arsimore të përcaktuara nga MASHT-i dhe përfshin moshat prej 15 deri në 17 vjeç.

Në Sektorin për Arsim punojnë 4 punëtorë përfshirë edhe drejtorin e drejtorisë, kurse në të gjitha nivelet arsimore janë të angazhuar 442 punëtorë nga të dy komunitetet.

Në këtë vit shkollor numri i nxënësve në institucionet edukative-arsimore të komunës së Dragashit është 3041. Duke e përfshirë arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm.

Vitin shkollor 2023/24 e kanë ndjekur 3041 nxënës, bashkë me 3 paralele, Qendra me Bazë në Komunitet **60** nxënës në Brodosanë dhe **26** nxënës në Dragash **mosha 3-5 vjet**, grupuar në 23 paralele, të shpërndarë në:

12 Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta;

23 Paralele të ndara të Shkollave Fillore;

1 Shkollë të Mesme të Lartë (Mikse);

Gjatë punës një vjeçare janë punuar 1485 lëndë administrative të cilat janë paraqitur sipas kërkesave e nevojave të shkollave, punëtorëve dhe organeve komunale.

- Vendime për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie,
- Vendim për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Kërkesa, përgjigje, ankesa, pëlqime etj.

Janë realizuar aktivitete kulturo-artistike me rastin e shënimit të ditëve të shkollave.

Drejtoria e Arsimit ka bërë mbikëqyrjen e procesit edukativo-arsimor, mbikëqyrje e cila është duke u realizuar në vazhdimësi nga drejtori dhe zyrtarët komunal të arsimit;

Sipas dinamikës së planifikuar, drejtori së bashku me zyrtarë kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e arsimit, përkatësisht në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe në shkollën fillore të mesme të lartë në komunën e Dragashit. Në kuadër të mbikëqyrjes

profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Dragashit, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë këtyre muajve, kanë realizuar vizita speciale dhe kontrolluese në institucionet arsimore.

- Është bërë kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASHT me qëllim të publikimit të konkursit për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë, në SHML (Shkollën e Mesme të Lartë) dhe përcjelljen e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollën e mesme të lartë.

- Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasave parafillore dhe parashkollore.

- Përgatitja për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë.

- Shpallja e konkursit të rregullt dhe plotësues është bërë me kohë për plotësimin e vendeve të lira të punës, mësimdhënës, punëtorë teknik. Janë pranuar 20 mësimdhënës, 2 ass. për fnva, 2 edukatore, 2 punëtor teknik, gjithsej të punësuar në arsim 26. Konkursi për komunitetin boshnjak i cili është në procedur të rekrutimit.

Gjithashtu është shpallë edhe konkursi për 6 drejtor shkolle dhe është në procedur.

- Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: ditarë pune, librat të kujdestarisë si dhe kalendarin shkollor.

- Përcjellja e punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve të maturantëve dhe semimaturantëve.

Furnizimi i të gjitha shkollave me lëndë djegëse.

- Përgatitja e raportit për suksesin dhe rezultatet e nxënësve të arritura në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/23.

- Drejtoria e Arsimit, në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka realizuar vizita në drejtoritë e shkollave për të bërë një analizë të detajuar mbi planifikimin dhe realizimin e punëve dhe detyrave të përcaktuara për drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar. Po ashtu janë analizuar të dhënat e ofruara nga drejtorët e shkollave .

Testi i Arritshmerisë për vitin 2023

Gjithsej **246** semimaturant të planifikuar nga 9 shkolla fillore, 7 shkolla Shqipe dhe 2 shkolla te komunitetit boshnjak.

Testit iu nënshtruan **244** nxënës. Organizimi i këtij testi është bërë në dy qendra testimi: në SHML “Ruzhdi Berisha” dhe në SHFMU “Fetah Sylejmani”- Dragash, në dy pjesë :

Pjesa e parë u mbajt me datë: 04.07.2023 dhe pjesa e dytë u mbajt me datë:11.06.2023 prapë në qendrën e njëjtë në SHML” Ruzhdi Berisha “dhe në SHFMU “Fetah Sylejmani”- Dragash, në dy pjesë :

Përqindja e nxënësve pjesëmarrës 99.19 %; 47.95 % M dhe 52.04 % F

Testi u administrua nga 27 mësimdhënës të komunës tonë, profesorë te SHML-së “ Ruzhdi Berisha “- Dragash.

Shkolla	Nr i nxënësve që iu nënshtrua testit të arritshmërisë	M	F	% e nx pjesëmarrës	M%	F%
SHML “ Ruzhdi Berisha “ dhe në SHFMU “F Sylejmani”	244	117	127	99.19	47.95 %	52.04 %

Matura Shtetërore për vitin 2023, u organizua në SHML “Ruzhdi Berisha”, me gjithsej **152** maturantë të planifikuar, ku testit ju nënshtruan 152 maturant. Administrimin e testit e kanë bërë mësimitdhënësit e komunës së Prizrenit. Në klasa kanë qenë deri në 15 nxënës për klasë. DKA-ja i ka kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme teknike me përpikëri. Testi ka filluar dhe ka përfunduar me kohë dhe nuk ka pasur asnjë problem. Përqindja e kalueshmërisë në afatin e **qershorit**, dhe në afatin e **gushtit 55.26 %**

Shkolla	Nr.i nxënësve që iu nënshtrua testit MATURA 2023	M	F	Kaluan	Nuk kaluan	% e kalueshmërisë	M%	F%
Ruzhdi Berisha								
Total	152	72	80	84	68	55.26%	47.36	52.63

Me datë: 22.05.2023 është mbajtur testi TIMSS, në SHFMU “Ilmi Bahtijari” - Blaç, me nxënës të klasës së IV.

Me kërkesë të Policisë së Kosovës - Dragash, janë mbajtur ligjëratat, për masat dhe sigurimin e një ambienti të sigurt në shkollat e komunës së Dragashit dhe dokumentarë për vetëdijesim mbi rreziqet e lëndëve narkotike dhe pasojat shëndetësore, shoqërore dhe ligjore" dhe "Ruajtja e Ambientit dhe Trashëgimisë Kulturore".

Gjithashtu vazhdon bashkëpunim i mirëfilltë me organizata të ndryshme siç janë: UNICEF, Caritasin Zvicërran, Ambasada Amerikane, JICA si dhe CIMIC-u Italian, Avoko, ECMI.

Me UNICEFIN është hapë Qendra me Bazë në Komunitet në fshatin Brodosanë, me dy paralele me fëmijë të moshës 3-5 vjeç. Gjithashtu janë angazhuar 3 edukatore, me këtë grup moshë me pagesë deri me 31.12.2024.

Kemi bërë Draft Planin Komunal të Veprimit për EPRBM i cili është përgatit nga Ekipi Komunal për PRBM në bashkëpunim me MASHT, UNICEF, ECMI.

Drejtoria e Arsimit në Dragash, po ashtu ka ndarë edhe bursa për studentet të Komunës së Dragashit, 110 bursa studentore.

Drejtoria e Arsimit i ka plotësuar këto vende duke i zhvilluar procedurat e rekrutimit duke u bazuar në Ligjet dhe Udhëzimet Administrative që e rregullojnë këtë fushë.

Pjesëmarrja e zyrtarëve për arsim gjithëpërfshirës në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian\ Këshilli i Evropës ‘ *‘Ndërtimi i Kapaciteteve për përfshirjen në Arsim’*’ – INCLUDE, si dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga MASHT-i

SFIDAT PËR VITIN 2023

1. Zëvendësimi i personelit arsimor (procedurat e stërzgjatura).
2. Rënia e numrit të nxënësve (rënia e numrit të orëve).
3. Problem i pagesës së shujtave (përmbaruesi)
4. Kërkesat për pushim pa pagesë për mësimdhënës

REKOMANDIMET

- Dezinfektimi i shkollave për nxënësit etj.
- Angazhimi i drejtoreshave të shkollave për përgatitjet rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2023/2024.

ÇËSHITJE TJERA

DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.

PARAQITJA TABELARE E AKTIVITETEVE KONTINUITALE

Raporti i punës lidhur me përgatitjen e objekteve shkollore për vitin shkollor 2023/24	KOHA E REALIZIMIT												Ëmplemtues	
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Përgatitjen e objekteve shkollore për vitin shkollor 2023/24														DKA
Përgatitja teknike e objekteve shkollore: gëlqerosja, dezinfektimi, vendosja e xhamave të dëmtuar, riparimi i inventarit, ekzistues dhe pajisja me inventar të ri.							√	√					√	DKA
Realizimi i procedurave për përzgjedhjen e operatorit furnizues me lëndë djegëse: dru, thëngjill, briket							√	√						DKA
Përzgjedhja e operatorit për										√				

furnizim e shkollave me lëndën djegëse në koordinim me Zyren e Prokurimit.														DKA
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse: dru dhe pelet, naftë										√	√			DKA
Kontrollimi i sistemit të ngrohjes nëpër shkolla.									√	√	√	√		DKA & Shkolla
Furnizimi i shkollave me mjete mësimore								√	√	√				DKA & Shkolla
Furnizimi i shkollave me inventar shkollor: banka, karrige, tavolina, tabela dhe dollapë për bibliotekat shkollore.						√	√	√						DKA & Shkolla
Mirëmbajtja (rregullimi) i shkollave dhe oborreve shkollore.				√	√	√	√	√	√					DKA & Shkolla
Mirëmbajtja (rregullimi) i terreneve sportive.				√	√	√	√	√	√					DKA & Shkolla
Furnizimi dhe mbikëqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore							√	√	√					MASHT DKA & Shkolla

Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave	Sipas kërkesave	DKA & Shkolla
Furnizimi i shkollave me karburante për gjeneratorë	Sipas kërkesave	DKA & Shkolla
Furnizimi i shkollave me materiale për zhvillimin e aktiviteteve të lira sipas prioriteteve të shkollave	Sipas kërkesave	DKA & Shkolla

Raporti i punës që ka të bëjë me procesin edukativo-arsimor për vitin shkollor 2023

Raport i punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2023	KOHA E REALIZIMIT												Implementime	
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Rregullimi i dokumenteve për pronat e shkollave sipas sipërfaqes kadastrale	E vazhdueshme												DKA	
Bashkëpunimi i DKA me MASHT- in për sistemin SMIA														DKA
Organizimi i mësimit shtesë për maturantët				√	√	√						√		DKA & Shkolla
Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbërua shkollore				√	√	√	√	√	√					DKA
Përcjellja e braktisjes së nxënësve detyrë e përhershme				√	√	√	√	√	√	√	√	√		DKA
Bashkëpunimi me OJQ në fushën e realizimit të drejtave të fëmijëve dhe				√	√	√	√	√	√	√	√	√		DKA

sigurisë së nxënësve në shkolla, detyrë e përhershme, kundër trafikimit, punës së fëmijëve në rrugë, drogës. etj.														
Analiza e punës edukativo – arsimore				√		√				√			DKA	
Përcjellja e lëvizjes së personelit arsimor	I përhershëm												DKA	
Shpallja e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas kërkesave të shkollave.	Sipas nevojës												DKA	
Plotësimi i vendeve të lira të punë	Sipas nevojës												DKA	
Vlerësimi i punës edukativo- arsimore të shkollave nëpërmjet vizitave dhe bashkëpunimit me prindër				√	√	√				√	√	√	√	DKA & Shkolla

Përgatitjet për kremtimin e festave shtetërore	√				√				√		DKA
Përcjellja e përhershme e aktiviteteve mësimore jashtë mësimore të nxënësve nëpër shkolla	E vazhdueshme										DKA&Shkolla
Mbarimi i mësimit për maturanët	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i										MASHT,DKA
Riprovimet për nxënësit që nuk kanë treguar rezultate pozitive në disa lëndë mësimore	Sipas kalendarit										Shkollat
Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i shkollës	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i										Shkolla, DKA,MASHT
Provimi i Maturës	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i										MASHT,DKA
Publikimi i rezultateve të provimit të Maturës	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i										MASHT,DKA
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i										MASHT,DKA
Publikimi i rezultateve të ankesave	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i										MASHT,DKA
Testi i arritshmerisë për klasat e nënta	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i										MASHT,DKA

Paraqitja e provimit për afatin e gushtit	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i	DKA
Provimi i maturës- afati i dytë	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i	MASHT,DKA
Publikimi i rezultateve të provimit të maturës, afati i dytë	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i	MASHT,DKA
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i	MASHT,DKA
Publikimi i rezultateve të ankesave	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHT-i	MASHT,DKA

Aktivitetet dhe bashkëpunimi i DKA-së me Kryetarin e Komunës, MASHT-in, drejtorët e drejtorive tjera komunale dhe me qytetarët

Aktivitetet dhe bashkëpunimi i DKA-së me Kryetarin e Komunës, MASHT-in, drejtorët e drejtorive tjera komunale dhe me qytetarët.	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Takimet dhe konsultimet me kryetarin e Komunës	I përhershëm, sipas nevojës												DKA
Takimet e rregullta me MASHT-in, në kuadër të takimeve me drejtorët e DKA-ve.	Të përhershme, varësisht nga ftesat												DKA, MASHT
Furnizimi me ligjet, udhëzimet, vendimet dhe rregulloret që dalin nga MASHT.	Sipas nevojës												DKA, MASHT

Përcjellja e kërkesave, raporteve dhe informatave nga aktiviteti i DKA-së në MASHT.	Sipas nevojës												DKA, MASHT	
Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kolegjiumit të Drejtorëve të DKA-ve të Kosovës.				√	√	√	√	√	√	√	√	√		DKA
Takimet e rregullta me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	DKA
Pranimi i raporteve mujore të punës nga drejtorët e shkollave dhe shqyrtimi i tyre.	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	DKA
Bashkëpunimi i rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, në veçanti me DKRS-në	I përhershëm, sipas nevojës												DKA	

Bashkëpunimi i rregullt me Zyrën e Inspeksionit të Arsimit në nivel regjional	Sipas nevojës	DKA
Puna me palët, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave	E përditshme dhe sipas nevojës	DKA
Bashkëpunimi me shoqata	Sipas nevojë	DKA

Bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë: Policinë, FSK-në, KFOR-in, OJQ-të dhe mediat.

Bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë: Policinë, FSK-në, KFOR-in dhe mediat	KOHA E REALIZIMIT												Implemtues
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Pjesëmarrja në debatet me temë arsimore e shoqërore e organizuar nga OJQ-të.	Sipas organizimit dhe ftesës												DKA
Bashkëpunimi me shërbimin policorë të Kosovës	Sipas nevojës												DKA
Bashkëpunimi me FSK-në	Sipas nevojës												DKA
Kontaktet me përfaqësues të KFOR-it dhe organizatave ndërkombëtare	Sipas kërkesave												DKA
Bashkëpunim me organizata të ndryshme vendore dhe të huaja	Sipas kërkesave												DKA
Bashkëpunim me donatorë vendorë	Sipas nevojës												DKA

Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Kuvendit Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane

Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Kuvendit Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane	KOHA E REALIZIMIT												Implemtues
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Përmirësimi i infrastrukturës transportit me nxënës dhe sigurisë në shkolla	Në vazhdimësi												DKA
Hartimi i programeve, planprogrameve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimit të mesimdhënësve me theks të veçantë integrimin e vajzave si temë specifike	Në vazhdimësi												DKA

Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për ndërtim dhe renovim si dhe hartimi i listës prioritare	Në vazhdimësi	DKA
Përmirësimi i hapësirave ekzistuese shkollore (renovim) dhe mbikëqyrja e punëtorëve gjatë renovimeve	Në vazhdimësi	DKA
Identifikimi i nevojave për materiale dhe pajisje si dhe përcaktimi i prioriteteve të shkollave me nevoja më të theksuara.	Në vazhdimësi	DKA
Përgatitja e draft rregullores për Kodin e Mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta	Në vazhdimësi	DKA

INVESTIMET KAPITALE PËR ARSIMIN NË DRAGASH 2023

Nr.	Projekti
1.	Renovimi i objekteve shkollore “Fetah Sylejmani”
2.	Renovimi i shkolles fillore “Svetlost” në Krushevë
3.	Renovimi i shkolles “9 Maj” në fshatin Rapçë
4.	Renovimi i shkolles fillore në fshatin Restelicë
5.	Renovimi i shkollës fillore “Ilmi Bahtijari” në fshatin Blaç
6.	Renovimi i shkollës fillore “Sezai Surroi” në fshatin Brrut
7.	Renovimi i shkollës fillore “Shaban Shabani” në paralelet e ndara Buçe, Brezne dhe Llopushnik
8.	Renovimi i shkollës fillore “Zenuni” në fshatin Brod
9.	Rregullimi i nxëmjes qendrore në shkollën fillore "Ulina" në fshatin Kosavë
10.	Ndërtimi i murit mbrojtës në shkollën fillore “Samidin Emin” në fshatin Kuk (faza e parë dhe faza e dytë)
11.	Renovimi i shkollës së mesme “Ruzhdi Berisha” në Dragash
12.	Rindërtimi i shkollës fillore “9 Maj” paralelja në Kërstec dhe parku i lojrave, financuar nga ambasada Bullgare
13.	Renovimi i banjove të shkollës “28 Nëntori”
14.	Renovimi i çerdhës në Dragash

TRANSPORTI I NXËNËSVE (JANAR-QERSHOR 2023)

Nr.	Transporti
1.	Transportimi i nxënësve Buzez-Bresane
2.	Transportimi i nxënësve Rrenc-Dragash
3.	Transportimi i nxënësve Pllave-Llapushnik
4.	Transportimi i nxënësve Zym-Bellobrad
5.	Transportimi i nxënësve Xërxe-Dragash
6.	Transportimi i nxënësve Kapre-Bellobrad
7.	Transportimi i nxënësve Pllajnik-Kosavë

TRANSPORTI I NXËNËSVE TË SHKOLLAVE FILLORE (SHTATOR-DHJETOR 2023)

Nr.	Transporti
1.	Transporti i nx shkollat fillore Pllajnik-Kosavë
2.	Transportimi i nx shkollat fillore Brrut-Bellobrad
3.	Transportimi i nx shkollat fillore Buzez-Bresane
4.	Transportimi i nx shkollat fillore Zym-Bellobrad
5.	Transportimi i nx shkollat fillore Kapre-Bellobrad
6.	Transportimi i nx shkollat fillore Pllavë-Llapushnik
7.	Transportimi i nx shkollat fillore Rrenc-Dragash
8.	Transportimi i nx shkollat fillore Zaplluxhe-Blaç
9.	Transportimi i nx shkollat fillore Brezne-Llapushnik
10.	Transportimi i nx shkollat fillore Zgatar-Blaç
11.	Transportimi i nx shkollat fillore Buçe-Llapushnik
12.	Transportimi i nx shkollat fillore Xërxe-Dragash
13.	Transportimi i nx i shkollave fillore Restelicë-Dragash

Nr.	Transporti
1.	Transporti i nx shkollës së mesme Llopushnik-Dragash (Brezne, Buçe, Pllavë, Rrenc)
2.	Transporti i nx shkollës së mesme Zaplluxhe-Dragash (Zaplluxhe, Blaç, Bresanë, Kuk, Buzez, Kosavë, Kapre, Zgatar, Brrut, Bellobrad, Zym)
3.	Transporti i nxënësve për ndjekjen e praktikës profesionale në Spitalin e Prizrenit (Dragash-Prizren ose Gjimnaz-Spital)

FURNIZIMET NË ARSIM PËR 2023

Nr.	Furnizimet
1.	Furnizimi me lëndë djegëse në shkolla dhe për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (dru)
2.	Furnizimi me ditarë në të gjitha shkollat
3.	Furnizim me material shkollor
4.	Furnizimi me lëndë djegëse (naftë për ngrohjen qendrore) në shkollën “Ruzhdi Berisha”
5.	Furnizim me pelet për AMF-te ne Restelicë, Brod, Rapçë dhe shkollën fillore “Fetah Sylejmani” dhe paralelën e ndarë në Shajne
6.	Furnizimi me toner për shkollat e K.K Dragash
7.	Furnizime me Letër A4 për gjitha shkollat
8.	Furnizime me material higjienik për gjitha shkollat
9.	Furnizime me fotokopjues në të gjitha shkollat amë
10.	Furnizime për zyrë
11.	Furnizime me inventarë



 Drejtori i DKA-së
 Zeni Krasniqi